



**DCAF**

a centre for security,  
development and  
the rule of law

# Qeverisja e Agjencisë së Inteligjencës në Kosovë

Florian Qehaja

**Strengthening Intelligence Governance in the  
Western Balkans**

# QEVERISJA E AGJENCISË SË INTELIGJENCËS NË KOSOVË

*FLORIAN QEHAJA<sup>1</sup>*

*© Autori i këtij publikimi i ruan të gjitha të drejtat autoriale të këtij publikimi. Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim nuk i reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e QKSS-së apo të partnerëve të saj*

---

<sup>1</sup> Florian Qehaja është Drejtor Ekzekutiv i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), institut (think-tank) ky i cili është joqeveritar dhe jo-fitimprurës e që merret me aktivitete hulumtuese dhe avokuese në Kosovë. Ai mban titullin Magjistër (MA) i Studimeve Bashkëkohore Evropiane nga Universiteti i Sussex, Mbretëritë e Bashkuara. Momentalisht është duke vijuar studimet e Doktoratës në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Lubjanës. Z. Qehaja është autor i një serie publikimesh në nivelin vendor dhe ndërkombëtar në fushën e reformimit të sektorit të sigurisë dhe studimeve të sigurisë në përgjithësi. Po ashtu ai në mënyrë aktive kontribuon në procesin e hartimit të politikave dhe draftimin e legjislacionit në Kosovë.

## CONTENTS

|                                                                         |    |
|-------------------------------------------------------------------------|----|
| <b>HYRJE</b> .....                                                      | 3  |
| <b>KONTEKSTI</b> .....                                                  | 4  |
| <b>1. THEMELIMI I AGJENCISË SË KOSOVËS PËR INTELIGJENCË (AKI)</b> ..... | 7  |
| 1.1. BASHKËPUNIMI LOKAL, RAJONAL E NDËRKOMBËTAR I AKI-SË .....          | 10 |
| <b>2. KONTROLLI DHE MBIKËQYRJA E AKI-SË</b> .....                       | 12 |
| 2.1. KONTROLLI I BRENDSHËM.....                                         | 12 |
| 2.2. MBIKËQYRJA PARLAMENTARE.....                                       | 13 |
| 2.3. ROLI I ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE DHE MEDIAVE.....           | 15 |
| 2.4. ROLI I INSTITUCIONEVE TË PAVARURA TË SHTETIT.....                  | 15 |
| 2.5. ROLI I GJYQËSORIT.....                                             | 16 |
| <b>FUQIZIMI I MBIKËQYRJES SË INTELIGJENCËS NË KOSOVË</b> .....          | 17 |
| <b>KONKLuzionET</b> .....                                               | 18 |
| <b>BIBLIOGRAFIA</b> .....                                               | 19 |
| BURIMET PRIMARE.....                                                    | 19 |
| BURIMET SEKONDARE .....                                                 | 19 |

## HYRJE<sup>2</sup>

Themelimi dhe zhvillimi i agjencisë vendore të inteligjencës në Kosovë ishte kontraverz për arsyejet që korrespondojnë jo vetëm në përvojat gjatë të kaluarës e që kanë të bëjnë me rolin e mëhershëm të policisë sekrete në ish-Jugosllavi por edhe për shkak të rrethanave unike që ndodhën në Kosovë pas shkatërrimit të ish-Jugosllavisë. Për më tepër, asnjë vlerësim i sektorit të sigurisë në Kosovë nuk mund të bëhet jashtë kontekstit të së kaluarës së afërt dhe në veçanti pa i përmendur edhe shërbimet jo-statutore të inteligjencës që operuan për më shumë se nëntë vite në shërbim të interesave partiake e në mungesë të agjencisë shtetërore të inteligjencës. Shqetësimet e shprehura nga opinioni publik lidhur me ish strukturat inteligjente si dhe droja për implikime politike e partiake në agjencinë shtetërore të inteligjencës, përbëjnë shqetësime shtesë të opinionit kosovar.

Shërbimi i tashëm inteligjent i cili është themeluar pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në shkurt të 2008 është vetëm disa vite në funksion dhe si rrjedhojë ende nuk ka arritur të jetë tërësisht i operacionalizuar. Janë për tu përshëndetur zhvillimet në raport me Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë (AKI) sidomos me aplikimin e aspekteve të qeverisjes së mirë në mekanizmat e kontrollit dhe qasja proaktive e ushtruar deri më tani nga komisioni mbikëqyrës parlamentar, por synimi strategjik për një mbikëqyrje konsistente e të qëndrueshme ende nuk është arritur. Për më shumë, roli mbikëqyrës i organizatave të shoqërisë civile dhe medias si dhe bashkëpunimi i kësaj agjencie me institucionet e pavarura shtetërore dhe gjyqësorit mbetet mjaft i kufizuar.

Ky studim ka për qëllim që të vlerësoj në mënyrë kritike progresin e bërë në fuqizimin e mbikëqyrjes demokratike të Agjencisë së Inteligjencës në Kosovë. Kjo përfshin një analizë të legjislacionit të aplikueshëm si dhe po ashtu merr në konsideratë kontekstin historik e politik. Për hartimin e tij janë përdorur kryesisht metodat kualitative të shkencave sociale, ku përfshin intervistimin e akterëve dhe ekspertëve të pavarur si dhe analizimin e burimeve të hapura. Periudha kohore e hulumtimit përfshin vitin 2010 dhe pjesën e parë të vitit 2011. Megjithatë, zhvillimet e mundshme pas kësaj periudhe nuk reflektojnë në këtë hulumtim. Poashtu, verzioni origjinal i hulumtimit është në gjuhën angleze kurse ky është verzioni i përkthyer në gjuhën shqipe. Kjo është bërë në kontekst të hulumtimit të përbashkët rajonal e që do të publikohet në gjuhën angleze.

---

<sup>2</sup> Ky tekst është shkruar si pjese e projektit të DCAF-it për Fuqizimin e Mbikëqyrjes së Inteligjencës në Ballkanin Perëndimor, projekt ky i cili u mundësua fal mbështetjes së Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës.

Studimi pritet të shërbejë si një burim i rëndësishëm për akterët në Kosovë si dhe në nivelin ndërkombëtar duke përfshirë veçanërisht deputetët e Kuvendit të Kosovës, organizatat e shoqërisë civile, mediat dhe universitetet. Po ashtu, studimi mund t'i shërbejë si një burim relevant personelit të AKI-së duke pasur parasysh që nuk ka asnjë studim deri më tani që vlerëson rolin e kësaj agjencie nga perspektiva jo-qeveritare.

Pjesa e parë e studimit synon të prezantojë një pasqyrë të shkurtër të së kaluarës së afërt të aktiviteteve të inteligjencës në Kosovë. Pjesa e dytë paraqet zhvillimet kryesore që çuan në krijimin e agjencionit të tashëm të inteligjencës. Kurse, pjesa e tretë përshkruan mekanizmat e themeluar për kontroll dhe mbikëqyrje të shërbimit duke përfshirë vlerësimin e efektivitetit të tyre. Studimi përmbyllet me disa rekomandime për fuqizimin e mbikëqyrjes së inteligjencës në Kosovë.

## **KONTEKSTI**

Çështja e komunitetit të inteligjencës si dhe perceptimet ndaj inteligjencës në Kosovë janë të ngjashme me ato të shteteve tjera në ish-bloku socialist. Kosova ishte pjesa e Jugosllavisë e cila kishte një sistem të centralizuar të sigurisë e që përfshinte shërbimin sekret të njohur ndryshe edhe si Departamenti i Sigurisë së Shtetit (UDBA). Ky shërbim kishte rol shumë të madh në atë sistem dhe si i tillë shërbente si shtyllë mbrojtëse e konceptit të Jugosllavisë. Megjithatë, aktivitetet e këtij shërbimi kundër të ashtuquajturve “armiqtë” potencial të sistemit jugosllav, dhe atë sidomos pas demonstratave të 1981 në Kosovë, bëri që ky sistem të perceptohej si i dhunshëm që shkaktonte represion dhe pasiguri, fenomen ky i cili ishte mjaft i theksuar sidomos ndaj popullatës shqiptare në Kosovë.

Ngjarje të rëndësishme në këtë drejtim u zhvilluan sidomos pas vitit 1989, ku edhe erdhi deri te abrogimi i autonomisë së Kosovës menjëherë pas konsolidimit të fuqishëm të regjimit nacionalist të Slobodan Millosheviçit në Serbi. Në të njëjtën kohë, regjimi i Millosheviçit futi nën kontroll aparaturën shtetërore të sistemit të sigurisë dhe organizoi atë konform rrethanave të reja të sigurisë që konsistonin në fillimin e shkatërrimit të Jugosllavisë dhe rrethanave të reja politike në Kosovë. Në federatën e re të ashtuquajtur Jugosllave, që nga viti 1989 e deri më 1999, regjimi i Millosheviçit përdori shërbimin sekret për represion ndaj shumicës shqiptare në Kosovë.

Fillimisht reagimet e shumicës shqiptare konsistonin në një lëvizje paqësore. Shpresat për pavarësinë e Kosovës u rritën sidomos pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Dejtonit në vitin 1995

që përfunduan luftën në Bosnje. Mirëpo, përderisa vazhduan politikat represive të regjimit të Millosheviçit, në ndërkohë doli në skenë Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) e cila filloi gradualisht ta zëvendësojë lëvizjen paqësore që ekzistonte në atë kohë. Njëra ndër njësitet e para të specializuara të UÇK-së ishte edhe Shërbimi Informativ i Kosovës i cili me gjasë ishte themeluar fillimisht si një shërbim ushtarak inteligjent.<sup>3</sup>

Në vitin 1999, pas refuzimit të Marrëveshjes së Rambouillet nga regjimi i Millosheviçit, udhëheqja e asokohshme politike e UÇK-së themeloi Qeverinë e Përkohshme të Kosovës. Pavarësisht që kjo qeveri operoi gjatë kampanjës ajrore të NATO-s dhe disa muaj më pas, ajo në fakt asnjëherë nuk pati njohje ndërkombëtare por që megjithatë tentoi të legalizoj (në një mënyrë) mandatin dhe aktivitetin e SHIK-ut.<sup>4</sup> Ekzistenca e këtij shërbimi dhe identiteti i personave kyç në SHIK ishte i njohur për publikun megjithatë detajet për strukturën dhe mënyrën e financimit nuk janë bërë të ditura kurrë.

Sipas ish drejtorit të SHIK-ut, Kadri Veseli, qëllimi i shërbimit ishte që t'i shërbejë “interesave nacionale dhe publike”.<sup>5</sup> Mirëpo, SHIK-u nuk kishte bazë juridike dhe si e tillë nuk dihej se si mund të funksiononte duke pasur parasysh bazën e saj të themelimit dhe ekzistencës. Në fakt, prezenca e SHIK-ut reflektonte një perceptim të njëjtë dhe të trashëguar tek popullata për ekzistencën e një organizate sekrete që operonte në mënyrë kundërthënëse në Kosovë.

Me 15 Qershor 2008, në një nga mediat televizive Veseli kishte deklaruar “përmbushjen e mandatit të SHIK-ut” dhe njoftoi publikisht shpërbërjen e këtij shërbimi.<sup>6</sup> Paraqitja publike e Veselit ndodhi në kontekstin e diskutimeve publike të cilat filluan tre vite më parë e që ndërlidheshin me aktivitetet përtej mbledhjes së informacioneve që SHIK-u supozohej se ishte involvuar. Këto diskutime fokusoheshin në ndërlidhjen e afërt politike të SHIK-ut me Partinë Demokratike të Kosovës (PDK) e që lidheshin me ish eprorë të UÇK-së. Çuditërisht, debati lidhur me aktivitetet e SHIK-ut u rrit pas shpërbërjes së saj në vitin 2008 kur disa parti politike opozitare dhe organizata të shoqërisë civile akuzuan PDK-në për “popullimin” e Qeverisë së Kosovës me ish agentë të SHIK-ut. Debati u bë edhe më intenziv në fund të vitit 2009 kur Nazim Bllaca, duke quajtur vetën ish agent i SHIK-ut, shpалosi për publikun involvimin e tij në aktivitetet për

---

<sup>3</sup> Disa burime thonë se SHIK ishte trashëgimtare e Njësisë së Zbulim Kundër Zbulimit të UÇK-së

<sup>4</sup> Instituti Kosovar për Politika Hulumtuese dhe Zhvillim (KIPRED), Shërbimet në hije të inteligjencës në Kosovë: Shpërbërje, Shkrirje apo Integrim? (Prishtinë: KIPRED, 2006), faqe 7

<sup>5</sup> TV KLAN Kosova, Intervistë me Drejtorin e SHIK Kadri Veseli, 28 Dhjetor 2009

<sup>6</sup> Deklarata e Drejtorit të SHIK, Kadri Veseli, RTK, 15 Qershor 2008

likuidimin fizik të oponentëve politik të bërë nga SHIK në periudhën 1999-2009 nën urdhrat e lidershipit të PDK-së.<sup>7</sup>

Në ndërkohë ishte bërë e njohur se edhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), parti kjo e dyta për nga madhësia pas PDK-së nga zgjedhjet parlamentare të vitit 2007, kishte shërbimin e saj të inteligjencës – Institutin për Hulumtime Strategjike dhe Opinion Publik (IHSOP). Sikurse SHIK-u, IHSOP po ashtu kishte në strukturë agjentë që vinin nga strukturat e luftës megjithatë disa analistë kanë bërë një dallim ku në bazë të disa observimeve pohonin se IHSOP ngërthente në vete një strukturë më të vjetër të kosovarëve ku supozohej se kanë shërbyer më parë në ish shërbimet sekrete të Jugosllavisë.<sup>8</sup>

Ngase shërbimet inteligjente partiake që vepruan në Kosovë para vitit 2009 nuk kishin bazë ligjore, qeveria nuk kishte autoritet ligjor që të ushtronte mbikëqyrje ndaj aktiviteteve të tyre. Si rrjedhojë, operacionet e tyre nuk përkonin me rendin demokratik dhe si të tilla reflektonin pasiguri tek popullata e Kosovës. Edhe pas shpërbërjes së SHIK dhe IHSOP, rëndësia e ish eprorëve të tyre dhe rrjetet që ata krijuan bënë që ata të mbeten ende me ndikim.

---

<sup>7</sup> Në momentin e bërjes së këtij studimi, rasti “Bllaca” ende është në procedurë gjyqësore

<sup>8</sup> Diskutime joformale me një ekspertë të pavarur, 14 Mars 2011

## 1. THEMELIMI I AGJENCISË SË KOSOVËS PËR INTELIGJENCË (AKI)

Pas tërheqjes së trupave serbe nga Kosova me 10 Qershor 1999, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara miratoi Rezolutën 1244 që vendosi Kosovën nën autoritetin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Rezoluta po ashtu autorizoi misionin paqeruajtës të udhëhequr nga NATO që njihet si KFOR. UNMIK dhe KFOR kishin përgjegjësinë kryesore për sigurinë publike në Kosovë në periudhën e pas-luftës. Gjatë periudhës nëntëvjeçare të qeverisjes ndërkombëtare të Kosovës (1999-2008), u zhvilluan institucionet vendore të sigurisë në mënyrë të pjesshme që kishin për qëllim ofrimin e shërbimeve për sigurinë publike posaçërisht me konsolidimin e policisë dhe strukturave të emergjencave civile.<sup>9</sup>

Autoritetet vendore si dhe organizatat e shoqërisë civile në Kosovë kërkuan vazhdimisht themelimin e agjencisë nacionale të inteligjencës që do të mblidhte informacion lidhur me kërcënimet e sigurisë nacionale mirëpo UNMIK-u kurrë nuk autorizoi themelimin e një agjencie të tillë ngase interpretonte shumë ngushtë Rezolutën 1244. Në vitin 2005, UNMIK-u dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) inicuan Rishikimin e Brendshëm të Sektorit të Sigurisë (RBSS) që kishte qëllim të dyfishtë: të vlerësoj konsolidimin e sektorit të sigurisë që nga 1999 si dhe të ofroj rekomandime për arkitekturën e re të sigurisë në Kosovë.<sup>10</sup> Raporti nënvizoi se Qeveria e Kosovës kërkoi themelimin e një agjencie vendore të sigurisë që do të ishte e aftë të mblidhte informacione lidhur me sigurinë nacionale si dhe të adresojë rreziqet dhe kërcënimet potenciale ndaj qytetarëve të Kosovës.

Në mars të vitit 2007, formimi i agjencisë vendore të inteligjencës u pa më afër se kurrë në momentin kur Përfaqësuesi Special i Kombeve të Bashkuara për Kosovë Marti Ahtisaari përfshiu themelimin e kësaj agjencie në propozimin gjithëpërfshirës e që u lansua pas bisedimeve të pasuksesshme në periudhën 2006-2007 ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit.<sup>11</sup> Propozimi i Ahtisaarit përfshinte rekomandime që u morën si bazë për shpalljen e Pavarësisë nga Kuvendi i Kosovës.

Me 17 shkurt 2008, diçka më shumë se një vit pas publikimit të propozimit të Ahtisaarit, Kuvendi i Kosovës shpalli pavarësinë e Kosovës dhe dy muaj më vonë miratoi kushtetutën e re. Kushtetuta në

<sup>9</sup> Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (KCSS), *Analiza e Kontekstit për Reformën e Sektorit të Sigurisë në Kosovë, 1999-2009* Prishtinë: 2011

<sup>10</sup> RBSS, *Rishikimi i Brendshëm i Sektorit të Sigurisë në Kosovë* (Prishtinë: RBSS, 2006)

<sup>11</sup> Zyra e Përfaqësuesit Special të Kombeve të Bashkuara për Kosovën, *Propozimi final gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës* (Mars 2007)



mënyrë eksplicite parashihte themelimin e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI) që ka për detyrë të “identifikojë, hetojë dhe monitorojë kërcënimet ndaj sigurisë në Republikën e Kosovës”.<sup>12</sup> Gjuha e përdorur në Kushtetutë ishte e përafërt me atë që ishte në propozimin e Ahtisaarit që propozonte themelimin e një agjencie vendore të inteligjencës “për të monitoruar kërcënimet ndaj sigurisë së brendshme në Kosovë”.<sup>13</sup> Po ashtu, kushtetuta parashihte që AKI “të jetë një institucion profesional, apolitik, shumë-etnik dhe t’i nënshtrohet mbikëqyrjes së Kuvendit”<sup>14</sup> e që përkonte me gjuhën e propozimit të Ahtisaarit se agjencia “duhet të jetë profesionale, apolitike, shumë-etnike dhe t’i nënshtrohet mbikëqyrjes parlamentare”.<sup>15</sup>

Në qershor të vitit 2008, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencës (më poshtë Ligji për AKI) që ofronte detajet specifike të mandatit të këtij institucioni si dhe paraqiste rregullimin në të cilën AKI do të operonte. Pjesë specifike të Ligjit për AKI kufizuan fuqitë ekzekutive të AKI duke eliminuar mundësitë për përdorimin direkt apo indirekt të forcës, arrestimin e qytetarëve apo edhe inicimin e hetimeve.<sup>16</sup>

Ngase procesi i hartimit të Ligjit për AKI ishte jo-transparent, është vështirë të dihet se kush në fakt ishte pjesë e hartimit të saj. Çka dihet është se legjislacioni ishte pjesë e ligjeve të Ahtisaarit të cilat kaluan nën të ashtuquajturën Rregullën 61, në të cilën procedura parlamentare parashihej të ishte e shpejtë. Nën Rregullën 61, deputetët e Kuvendit të Kosovës kishin vetëm një ditë sesion për të konsideruar shqyrtimin e draftit dhe se shqyrtimi eventual i ligjit nuk u bë nëpërmjet komisioneve permanente parlamentare mirëpo, u themelua një komision ad hoc që u morr posaçërisht me vlerësimin e legjislacionit në Rregullën 61.<sup>17</sup>

Mënyra e përshpejtuar e miratimit të ligjit për AKI bëri që shumë qytetarë të mendojnë se legjislacioni u imponua nga bashkësia ndërkombëtare dhe si i tillë mund të mos reflektojë në mënyrë adekuate kontekstin lokal. Disa kritikë argumentojnë se ligji sipas gjitha gjasave është hartuar në gjuhën angleze që si rrjedhojë përfshinë “përmbajtje kaotike për shkak të përkthimit të

---

<sup>12</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 129.1

<sup>13</sup> Zyra e Përfaqësuesit Special të Kombeve të Bashkuara për Kosovën, *Propozimi final gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës* (2007)

<sup>14</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 129.2

<sup>15</sup> Zyra e Përfaqësuesit Special të Kombeve të Bashkuara për Kosovën, *Propozimi final gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës* (2007)

<sup>16</sup> Ligji për AKI, Neni. 3.1

<sup>17</sup> Instituti GAP, Rregulla 61: *Ligjet e Ahtisaarit – konsekuencat dhe mësimet e nxjerra nga miratimi i ligjeve në procedurë të shpejtë* (Dhjetor 2010), faqe 3; si dhe pjesëmarrja me observim e autorit në konferencën e datës 27 Janar 2011 të Institutit GAP “*Ligjet e Pakos së Ahtisaarit – dy vite nga fillimi i zbatimit të tyre*”.

dobët dhe palogjikshëm”<sup>18</sup> duke bërë që nenet e ligjit të jenë të pakuptueshme dhe vështirë të interpretueshme (siç është rasti me versionin në gjuhën shqipe).

Përshpejtimi i miratimit të ligjit për AKI dhe veçanërisht mungesa e debatit publik deri në një masë do të mund të arsyetohej për shkak të nevojës për futjen në zbatim të ligjit brenda një kohe të shkurtër si dhe domosdoshmërisë për themelimin e institucioneve shtetërore të Kosovës. Megjithatë, ligji për AKI ende mund të i nënshtrohet amandamentimit dhe se ligjvënësit tashmë kanë mundësi të marrin në konsideratë përvojën e bërë nga zyrtarët e AKI-së si dhe të mekanizmave mbikëqyrës. Qartazi, një proces i tillë ende nuk ka filluar.

Nga aspekti operativ, AKI është ende në fazën e hershme të zhvillimit. U desh gati një vit që Presidenti dhe Kryeministri, që kanë përgjegjësi të njëjtë,<sup>19</sup> të emërojnë drejtorin e parë të AKI-së. Publiku kurrë nuk i mësoi arsyet e kësaj vonese megjithëse kishte një supozim të përgjithshëm se këto vonesa konsistonin në kontrollin politik të dy liderëve mbi agjencinë dhe veçanërisht tendencat për influencë të ish pjesëtarëve të strukturave inteligjente partiake. Emërimi i drejtorit ishte konkluduar përfundimisht në shkurt të vitit 2009 si pjesë e marrëveshjes që përfshinte në ndërkohë edhe emërimin, mbase të vonuar, të Zëvendës Drejtorit dhe Inspektorit të Përgjithshëm.

Duke pasur parasysh kontekstin historik dhe sidomos rolin e ish pjesëtarëve të shërbimeve inteligjente partiake, zhvillimi i AKI-së në fakt kaloi nëpërmjet disa stadeve sfiduese. Njëra ndër to ishte ndërtimi i një imazhi që e diferenconte AKI-në nga strukturat siç ishin SHIK apo IHSOP. Perceptimet negative ndaj këtyre ish strukturave partiake, dhe sidomos pas akuzave në “rastin Bllaca” kanë bërë të vështirë ndërtimin e një imazhi kredibil e pozitiv të AKI-së. Ndoshta jo gjithmonë të saktë, disa parti opozitare dhe pjesëtarë të shoqërisë civile kanë ngritur shqetësimet për përfshirjen e ish pjesëtarëve të SHIK-ut në pozicione të ndryshme të AKI duke argumentuar se një praktikë e tillë nënvlerëson karakterin apolitik të agjencisë. Me fjalë të tjera, opinionin publik manifestoi frikën për mundësinë e ndërlydhjes së ish pjesëtarëve të SHIK-ut me AKI-në e tashme. Se a janë të vërteta këto vlerësime është vështirë të thuhet duke pasur parasysh që AKI është një organizatë e mbyllur dhe me mungesë të plotë të transparencës. Në përgjithësi mund të thuhet se profili real i AKI-së mund të ndërtohet vetëm nëse në vitet e ardhshme ajo t’i tejkaloj skandalet dhe kundërthëniet në mënyrë që të ndryshojë perceptimi publik dhe besimi ndaj këtij institucioni.

<sup>18</sup> Citim nga Abdullah Prapashtica, Lajme Dervina , <http://lajme.dervina.com/archive/arkivi.php?lajmi=4749-1596:489&printo=4749-1596:489>

<sup>19</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 129.3

Krahas shqetësimeve për “politizimin” e AKI-së po ashtu ekzistojnë disa shqetësime për mundësinë e “policizimit” të kësaj agjencie. Intervistat me akterët kanë shpalosur frikën që një numër i ish-policëve janë rekrutuar në AKI pavarësisht mandatit të saj jo-policor.<sup>20</sup> Edhe pse përvoja e zyrtarëve policor mund të jetë e vlefshme, veprimet policore dhe mentaliteti policor mund të mos janë kompatible me mënyrën e operimit të agjencisë siç parashihet në Ligjin për AKI.

Ekzistojnë shumë pak informacione në publik lidhur me aktivitetet operationale të AKI-së. Njëra ndër burimet që ja vlen të përmendet është “Raporti i Shteteve për Terrorizmin” i Departamentit Amerikan të Shtetit për vitin 2009 që përshëndeti performancën e agjencisë së posathemeluar – AKI-së, në identifikimin e disa celulave terroriste islamike në Kosovë. Sipas këtij raporti, AKI “dyshonte se disa organizata joqeveritare islamike ishin të involvuara në disa aktivitete të dyshimta për pastrimin e parasë në funksion të akteve të ardhshme terroriste në Lindjen e Mesme”.<sup>21</sup> Pavarësisht kësaj, mungesa e disa burimeve e bënë të vështirë vlerësimin e efektivitetit të AKI-së deri më tani.

Niveli i aplikimit të parimeve të qeverisjes së mirë në AKI është një çështje shtesë me interes për hulumtuesit e sidomos organizatat e shoqërisë civile. Fakti se AKI u krijua nga zeroja ngriti shpresën për aplikimin e praktikave më të mira të qeverisjes demokratike paralelisht me zhvillimin e saj. Është e pritshme një lloj mungese e transparencës së kësaj agjencie veçanërisht në të ashtuquajturat “zonat e hirta” të punës së inteligjencës. Mirëpo, edhe ky arsyetim nuk shpjegon sjelljen e kësaj agjencie deri më tani e cila është komplet e mbyllur për publikun e që rrjedhimisht bllokoi edhe qasjen në të dhëna/informacione që mundin lehtësisht të bëhen transparente. AKI rrallë ka komunikuar me publikun dhe se rasti më eklatant është mungesa e web-faqës së kësaj agjencie. Funksionimi jo-transparent i AKI-së e bënë të vështirë vlerësimin e performancës së saj në përputhje me legjislacionin e sundimin e ligjit.

## **1.1. BASHKËPUNIMI LOKAL, RAJONAL E NDËRKOMBËTAR I AKI-SË**

Ligjet relevante kërkojnë që AKI të vendos bashkëpunim me institucionet tjera të brendshme të sigurisë në Kosovë – bashkëpunim ky që me gjasë është formalizuar në disa raste. Raportet e mediave kanë treguar arritjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit në mes të AKI-së dhe policisë si

---

<sup>20</sup> Intervistë me një ekspertë të pavarur në Kosovë, 12 Mars 2011

<sup>21</sup> Departamenti Amerikan i Shtetit, *Raporti i Shteteve kundër Terrorizmit 2009* (Gusht 2010), faqe 89

dhe doganave mirëpo nuk ka informacion të hapur për arritjen e marrëveshjes me Forcën e Sigurisë së Kosovës apo edhe institucionet tjera të sigurisë. Por, de fakto bashkëpunimi ekziston.

Bashkëpunimi me shërbimet e huaja të inteligjencës është një çështje tjetër. Ligji për AKI i jep drejtorit autorizime për të vendosur kontakte me shërbimet tjera të inteligjencës mirëpo këto nene nuk parashohin nevojën që ky bashkëpunim t'i nënshtrohet kontrollit apo mbikëqyrjes parlamentare. Autori i këtij publikimi nuk mund të gjente asnjë informacion të hapur lidhur me bashkëpunimin e AKI-së me shtetet tjera, megjithatë mund të thuhet se një bashkëpunim i tillë tanimë ekziston me shërbimet inteligjente të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian. Por edhe fakti se kemi të bëjmë me një prani të madhe të bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë na bënë të konstatojmë se ekziston një prani po ashtu aktive e shërbimeve të huaja inteligjente në vend.

Bashkëpunimi rajonal është i paevitueshëm për shkak të kërcënimeve dhe rreziqeve të përbashkëta gjeografike në rajonin e Ballkanit. Krimi i organizuar dhe terrorizmi ndikojnë në zhvillimin e çdo shoqërie në këtë rajon por, është më se e qartë që AKI duhet t'i balancojë kërcënimet rajonale me situatën delikate politike në Kosovë sidomos duke pasur parasysh vështirësitë në njohjen ndërkombëtare të Kosovës. Drejtori i AKI-së publikisht ka potencuar se ekziston një bashkëpunim i mirë i AKI-së dhe partnerëve rajonal, posaçërisht me Shërbimin Informativ të Shtetit (SHISH).<sup>22</sup> Nuk ka asnjë burim të hapur që do të mund t'i vlerësonte bashkëpunimet në nivel rajonal mirëpo supozohet se ende nuk ka bashkëpunimin në mes AKI-së me agjencitë simotra të Serbisë dhe Bosnjës duke pasur parasysh qëndrimin kundër njohjes së pavarësisë së Kosovës.

---

<sup>22</sup> RTK, Intervistë me Drejtorin e AKI, Janar 2011

## 2. KONTROLLI DHE MBIKËQYRJA E AKI-SË

Sikurse që agjencia është në fazën e hershme të zhvillimit po ashtu, e njëjta qëndron edhe me mekanizmat e kontrollit dhe mbikëqyrjes. Në mënyrë që të kuptojmë se si funksionojnë këto mekanizma është më se e rëndësishme të dihet pozicioni i AKI-së në hierarkinë vertikale të Qeverisë së Kosovës. Bazuar në kornizën ligjore, AKI është agjenci e pavarur që i raporton direkt Kryeministrit si dhe Presidentit. Agjencia nuk është pjesë e strukturës së ndonjë ministrie dhe as nuk është pjesë e zyrës së Kryeministrit. Për më tepër, Drejtori i AKI-së është anëtar i Këshillit të Kosovës në cilësinë e këshilltarit.<sup>23</sup> Në përgjithësi, vlen të theksohet se përderisa ka aktorë që mbështesin këtë mënyrë të funksionimit që i përgjigjet Kryeministrit si dhe një pjesë tjetër avokojnë për agjenci nën ombrellën e Ministrisë (qoftë Ministrisë së Punëve të Brendshme apo Punëve të Jashtme) megjithatë, është më se e vërtetë se agjencitë që i raportojnë direkt Kryeministrit mund të konsiderohen sikurse Ministri pa portofolio.<sup>24</sup>

### 2.1. KONTROLLI I BRENDSHËM

Mekanizmat e kontrollit të brendshëm të AKI-së reflektojnë një strukturë të funksionimit në bazë të sistemit të balancit e kontrollit. Kapitulli i III-të i Ligjit për AKI përshkruan në detaje fuqitë dhe përgjegjësitë e Inspektorit të Përgjithshëm i cili është emëruar bashkërisht nga Presidenti dhe Kryeministri.<sup>25</sup> Fakti se Inspektori i Përgjithshëm emërohet direkt nga Presidenti dhe Kryeministri e bënë atë më të fuqishëm në ushtrimin e funksioneve të kontrollit të brendshëm e që nuk është rasti me shtetet tjera të rajonit. Inspektori i Përgjithshëm emërohet për katër vite me mundësi të vazhdimit edhe për katër vite të tjera.<sup>26</sup> Inspektori i Përgjithshëm ka mandat t'i raportoj Kryeministrit dhe komisionit relevant parlamentar lidhur me aktivitetet e AKI-së. Mund të iniciojë hetime të brendshme, të bëjë auditimin financiar si dhe të rekomandojë përmirësime të gjendjes.<sup>27</sup>

Vonesat në zhvillimin e AKI-së kanë reflektuar po ashtu në konsolidimin e kontrollit të brendshëm. Deri në pjesën e parë të vitit 2011, mekanizmat e kontrollit të brendshëm të agjencisë kanë funksionuar me kapacitete të pjesshme ku ende nuk janë rekrutuar të gjithë zyrtarët e planifikuar.<sup>28</sup> Sipas zyrtarëve, problemi i mos kompletimit të stafit ka të bëjë me procedurat e komplikuar dhe

---

<sup>23</sup> Ligji për Këshillin e Sigurisë së Kosovës, Neni 3.4

<sup>24</sup> Intervistë me një zyrtarë nga një nga shtetet e Bashkimit Evropian, 03.03.2011

<sup>25</sup> Ligji për AKI, Neni 9.1

<sup>26</sup> Ligji për AKI, Neni 9.2

<sup>27</sup> Aty, Neni 9.2

<sup>28</sup> Intervistë me Inspektorin e Përgjithshëm të AKI Agron Selimaj, 30 Mars 2011

shumë të ndjeshme për të rekrutuar dhe trajnuar stafin. Në ndërkohë, kapacitetet operacionale të Inspektorit të Përgjithshëm vazhdojnë të rriten.<sup>29</sup>

Njëra ndër sfidat e mundshme në të ardhmen që mund të ndikojë në funksionimin efektiv të mekanizmave të kontrollit të brendshëm të AKI-së ka të bëjë me një dykuptimësi në ligjin për AKI që i mundëson Drejtorit ndalimin e hetimeve nga Inspektori i Përgjithshëm nëse Drejtori konsideron se kjo është në dobi të mbrojtjes së interesave vitale të sigurisë”.<sup>30</sup> Ky nen është shumë i gjerë dhe si i tillë len hapësirë për interpretim aq më parë që mandati i AKI-së për mbledhjen e informacioneve lidhur me interesat vitale të sigurisë mund të përfshijë gati çdo aktivitet të agjencisë.<sup>31</sup> Për këtë arsye, ligji për AKI-në duhet të modifikohet në mënyrë që të shmanget keqpërdorimi potencial i këtij neni në të ardhmen.

## 2.2. MBIKËQYRJA PARLAMENTARE

Kapitulli i VII-të i Ligjit për AKI kërkon që Kuvendi i Kosovës duhet të themelojë një “komision mbikëqyrës parlamentar” me mandatin kryesor për të “mbikëqyrur legalitetin e punës së AKI”<sup>32</sup> (Mandati i këtij komisioni po ashtu përfshinë shqyrtimin e raporteve lidhur me operacionet dhe shpenzimet e AKI). Bazuar në këtë obligim ligjor, në nëntor të vitit 2009 Kuvendi i Kosovës formoi Komisionin Parlamentar për Mbikëqyrjen e AKI.<sup>33</sup> Ligji për AKI fuqizon rolin e komisionit në inicimin e seancave në rast se ekzistojnë dyshime se “AKI është duke performuar në mënyrë të paligjshme, papërshtatshme apo joprofesionale”.<sup>34</sup>

Informacionet e ofruara nga zyrtarët e komisionit tregojnë një qasje proaktive të këtij komisioni në vitin e parë të funksionimit të tij.<sup>35</sup> Gjatë vitit të parë të funksionimit (2010), komisioni u takua 12 herë apo thënë më ndryshe një herë në muaj. Gjatë këtyre takimeve, deputetët miratuan raportin vjetor si dhe shtruan 39 çështje për diskutim dhe morën 3 vendime. Në përgjithësi, aktiviteti i madh i këtij komisioni e bënë atë një ndër organin më të rëndësishëm për mbikëqyrjen e AKI-së në Kosovë. Edhe pse kontaktet e shpeshta ndërmjet mediave dhe deputetëve të këtij komisioni kanë ndihmuar procesin e mbikëqyrjes, qasja e gazetarëve ka qenë e kufizuar si rezultat i sesioneve të mbyllura të këtij komisioni.

<sup>29</sup> Po aty

<sup>30</sup> Ligji për AKI, Neni 10.6

<sup>31</sup> QKSS, Funksionet e kontrollit të institucioneve pavarura shtetërore në sektorin e sigurisë në Kosovë, faqe 103

<sup>32</sup> Ligji për AKI, Neni 36.6

<sup>33</sup> Korrespondencë me email me Nur Çeku, Koordinator i Komisionit për Mbikëqyrje Parlamentare të AKI, 31 Janar 2011

<sup>34</sup> Ligji për AKI, Neni 37.1

<sup>35</sup> Korrespondencë me email me Nur Çeku, Koordinator i Komisionit për Mbikëqyrje Parlamentare të AKI, 31 Janar 2011

Komisioni është i përbërë nga nëntë anëtarë, shumica e të cilëve i takon koalicionit aktual qeverisës. Megjithatë, kryetari i komisionit nuk duhet t'i takoj koalicionit qeverisës.<sup>36</sup> Përderisa i është kushtuar vëmendje përfshirjes së minoriteteve në komision, megjithatë nuk kishte vëmendje për përfshirje gjinore. Për momentin, vetëm një anëtare e komisionit është femër, gjë që reflekton interes të kufizuar të partive politike në pozicionimin e gruas në komisionet e sferës së sigurisë (gratë përbëjnë 1/3 e Kuvendit të Kosovës).

Në mënyrë që të kryejnë funksionet e tyre mbikëqyrëse, anëtarëve të komisionit i duhet qasje në informacionet e klasifikuara. Ligji për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë, me përjashtim të Presidentit, Kryeministrit dhe Kryetarit të Kuvendit, kërkon nga secili, përfshirë dhe deputetët e Kuvendit të Kosovës t'i nënshtrohen verifikimit të besueshmërisë para se të kenë qasje në informacionet e klasifikuara. Kjo e len të hapur mundësinë që deputetit mund t'i refuzohet kërkesa për qasje në informacion të klasifikuar. Hartuesit e ligjit në fjalë kishin parasysh papjekurinë e demokracisë kosovare si dhe sistemin e dobët elektoral që ka rezultuar në disa raste në zgjedhjen e dyshimtë të deputetëve. Për më tepër, edhe në rast të verifikimit të besueshmërisë së deputetëve atyre mund të i ndalohet qasja në informacione të klasifikuara nëse "hapja e këtyre informacioneve rrezikon interesat vitale të sigurisë nacionale që ndërlidhen me mbrojtjen e një burimi apo metode të rasteve specifike".<sup>37</sup>

Njëra ndër dobësitë më të mëdha të komisionit ka të bëjë me mungesën e konsistencës dhe atë për disa arsyeje. Komisioni ka një rol proaktiv për shkak të rolit të kryetarit të komisionit dhe disa deputetëve (kryesisht nga opozita) mirëpo, varësia në individë mund ta largojë konsistencën në funksionimin e këtij komisionit. Në ndërkohë, anëtarët e komisionit nga koalicioni qeverisës si dhe opozita kanë tendencë që të imponojnë agjendat e tyre në diskutimet e komisionit në mënyrë që të largojnë fokusin real të komisionit. Për shembull, diskutimet disa mujore në çështjet e shërbimeve inteligjente partiake kanë larguar vëmendjen e komisionit në kryerjen e detyrave siç përkojnë me mandatin e saj – mbikëqyrjen e AKI-së.<sup>38</sup> Në anën tjetër, komisioni relevant ka vetëm dy zyrtarë administrativ që ndihmojnë funksionimin e komisionit mirëpo, nuk ka asnjë këshilltarë që do të ndihmonte në aspektin profesional. Është më se e qartë se komisioni do të mund të përfitonte nga angazhimi i ekspertëve të jashtëm.

---

<sup>36</sup> Ligji për AKI, Neni 36.2

<sup>37</sup> Aty, Neni 37.6

<sup>38</sup> Raporti i Progresit – Made in Kosova, p.31

Përveç Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrje të AKI-së, komisionet tjera që kanë mandat të mbikëqyrin AKI-në përfshinë: Komisioni për Buxhet dhe Financa që aprovon buxhetin vjetor të AKI-së; Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike që shqyrton shpenzimet buxhetore të AKI dhe raportet e auditimit si dhe Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, mandati i së cilës është mbikëqyrja e të drejtave të minoriteteve në rast të shkeljeve të mundshme.

### **2.3. ROLI I ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE DHE MEDIAVE**

Roli i organizatave të shoqërisë civile dhe mediave në mbikëqyrjen e AKI-së është relativisht i dobët. Vetëm disa organizata jo-qeveritare bëjnë hulumtime apo monitorojnë performancën e kësaj agjencie dhe se vetëm disa raporte janë fokusuar në qeverisjen e mirë të AKI-së.<sup>39</sup> Krahasimisht, media ka pasur një rol më të madh në përcjelljen e ngjarjeve lidhur me zhvillimin institucional të AKI-së. Siç është elaboruar më lartë, mediat kanë ngritur shqetësimet për implikime politike në këtë agjenci dhe kanë monitoruar performancën e AKI-së si dhe funksionimin e komisionit relevant parlamentar duke bërë intervista të shpeshta me deputetët.<sup>40</sup> Raportimi i mediave do të ishte edhe më informativ nëse AKI nuk do të i rezistonte ngritjes së nivelit të transparencës ndaj publikut. Përveç disa informimeve të shkurtra nga gazetarët, AKI ka qenë e heshtur ngase nuk ka publikuar as një komunikatë për media apo raport.<sup>41</sup>

### **2.4. ROLI I INSTITUCIONEVE TË PAVARURA TË SHETIT**

Deri në momentin e finalizimit të këtij studimi, institucionet e pavarura të shtetit nuk kanë ushtruar as një rol mbikëqyrës ndaj AKI-së. Ombudspersoni dhe Auditori i Përgjithshëm kanë përgjegjësi për monitorimin e mbikëqyrjes së shkeljeve të mundshme të të drejtave të njeriut si dhe shpenzimet e parasë publike. Deri më tani, asnjë rast i shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e AKI-së nuk është raportuar nga Ombudspersoni,<sup>42</sup> me gjasë për shkak të praktikës së kufizuar të AKI-së. Megjithatë, është më se shqetësuese fakti se Auditori i Përgjithshëm ende nuk ka bërë auditimin e shpenzimeve të AKI-së,<sup>43</sup> pavarësisht detyrimit që të gjitha fondet publike t'i nënshtrohen auditimit të jashtëm. Përderisa AKI argumenton për natyrën konfidenciale të buxhetit dhe shpenzimeve, megjithatë,

---

<sup>39</sup> Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) është një ndër organizatat (think tank) më aktive në vlerësimin e qeverisjes së mirë në sektorin e sigurisë

<sup>40</sup> Përderisa minutat e takimeve të komisioneve tjera parlamentare janë të hapura, minutat e takimit të Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrjen e AKI nuk janë të hapura për publikun

<sup>41</sup> Intervistë me specialistin e komunikimeve në sektorin e sigurisë, Abit Hoxha, 24 Mars 2011

<sup>42</sup> QKSS, Funksionet e Kontrollit të Institucioneve të Pavarura të Shtetit në Sektorin e Sigurisë në Kosovë, faqe. 34

<sup>43</sup> Po aty,



mund të gjenden moduse përfshirë edhe verifikimin e besueshmërisë së auditorëve të caktuar në këtë detyrë.

## **2.5. ROLI I GJYQËSORIT**

Në rrethana normale, gjyqësori do të mund të luante një rol të rëndësishëm që të sigurohet legaliteti i operacioneve të agjencisë së inteligjencës. Mirëpo, fakti se gjyqësori në Kosovë është i dobët është vështirë të pritet që gjyqtarët të ushtrojnë kontroll të duhur në një të ardhme të afërt. Ligji për AKI-në në mënyrë eksplicite kërkon miratimin e gjyqtarit të Gjykatës Supreme para se AKI të filloj përdorimin e masave speciale investigative siç janë survejimi në vendet jopublike apo edhe përgjimet e telekomunikimeve.<sup>44</sup>

---

<sup>44</sup> Ligji për AKI, Neni 28.1

## FUQIZIMI I MBIKËQYRJES SË INTELIGJENCËS NË KOSOVË

Duke pasur parasysh mungesën e informacioneve lidhur me performancën e AKI-së si dhe përvojën e vogël të kësaj agjencie, është më se e nevojshme që të ofrohen disa sugjerime tentative për ndryshime në mbikëqyrjen e AKI-së. Rekomandimet janë si më poshtë:

- Komisioni relevant parlamentar duhet t'i kushtoj rëndësi konsistencës në kryerjen e detyrave të saj mbikëqyrëse;
- Kuvendi duhet të rris numrin e stafit mbështetës për komisionet relevante parlamentare duke përfshirë edhe ekspertët e shoqërisë civile që do të mund të këshillonin komisionin në kontrollin dhe mbikëqyrjen e punës së inteligjencës;
- Komisioni relevant e sidomos AKI duhet të jenë më shumë transparent në mënyrë që publiku të jetë më shumë i informuar. AKI, duhet të krijojë web-faqën e saj që do të publikonte informacione lidhur me mandatin e saj në mënyrë që të ndërtojë besimin e publikut;
- Roli i Inspektorit të Përgjithshëm duhet të jetë më i theksuar si dhe neni që ia mundëson drejtorit të AKI-së të ndaloj inicimin e hetimeve nga Inspektori i Përgjithshëm duhet të modifikohet;
- AKI dhe organizatat e shoqërisë civile duhet të angazhohen bashkërisht lidhur me çështjet strategjike në sferën e inteligjencës. Diskutimet në tryeza që përfshijnë AKI-së dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile si dhe ekspertët e pavarur dhe përfaqësuesit e jetës akademike, mund të shërbejnë si një platformë efektive e komunikimit.
- Komunikimi ndërmjet AKI-së dhe mediave duhet po ashtu të përmirësohet, në mënyrë që të mundësohet qasja në informacione e që si rrjedhojë media do të mund të informonte më mirë opinionin publik. Në veçanti, AKI duhet të krijojë një zyre për komunikim ose së paku të emërojë një zëdhënës që do të transmetonte informacionet e jo-klasifikuara tek gazetarët si dhe adresojë pyetjet e mundshme.

- Auditori i Përgjithshëm i Kosovës duhet të filloj sa më parë auditimin e pasqyrave financiare të AKI-së dhe të caktoj auditorët përkatës në mënyrë që të fillojë verifikimin i sigurisë, nëse është e nevojshme.

## KONKLuzionet

Aktiviteti i kufizuar i AKI-së deri më tani e bënë të vështirë vlerësimin e funksionalitetit të vet agjencisë si dhe mekanizmave mbikëqyrës. Megjithatë, mungesa e informacioneve dhe të dhënave nuk e amnistion AKI-në nga analizat dhe kritikrat e mundshme. Frika se ky institucion rishtazi i themeluar mund të trashëgojë dobësitë e shërbimeve inteligjente partiake mbetet reale përderisa, ekzistojnë shqetësime në publik për implikimet e mundshme të SHIK dhe IHSOP. Këto shqetësime, kontribuojnë në perceptimin se politizimi është pjesë normale e çdo shërbimi inteligjent dhe rrjedhimisht kjo shton tutje rrezikun e dëmtimit të imazhit publik të agjencionit.

Me fjalë të tjera, AKI duhet të zhvillojë profilin e saj që thekson një hapje më të madhe ndaj publikut dhe profesionalizëm se sa mbyllje apo qasje sekrete. AKI mund të fillojë të aplikojë një qasje më proaktive në marrëdhëniet me mediat dhe shoqërinë civile. Në këtë mënyrë, AKI do t'i jepte fund perceptimit për ndërlidhjen me të kaluarën.

Ngritja e influencës së komisionit relevant parlamentar është një çështje tjetër që është esenciale në fuqizimin e mbikëqyrjes së AKI-së. Mirëpo, kontrolli parlamentar si i tillë është jo i mjaftueshëm. Organizatat e shoqërisë civile, media dhe institucionet e pavarura të shtetit po ashtu, mund të përfshihen në procesin e mbikëqyrjes nëse dëshirojmë të kemi një mbikëqyrje të suksesshme. Vetëm kur atëherë të gjitha pjesët e shoqërisë funksionojnë në një sistem të integruar mund të arrihet qëllimi për një mbikëqyrje demokratike. Nga momenti i bërjes së këtij studimi, mbetet shumë për tu bërë në avancimet në këtë drejtim.

## BIBLIOGRAFIA

### BURIMET PRIMARE

1. Intervistë me Inspektorin e Përgjithshëm të AKI, Agron Selimaj, 30 Mars 2011
2. Intervistë me një zyrtarë në një nga shtetet e Bashkimit Evropian, 3 Mars 2011
3. Intervistë me specialistin e komunikimeve në sektorin e sigurisë, Abit Hoxha, 24 Mars 2011
4. Intervistë me një ekspertë të pavarur në Kosovë, 12 Mars 2011
5. Korrespondencë me email me Nur Çeku, Koordinator i Komisionit për Mbikëqyrjen e AKI, 31 Janar 2011
6. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008
7. Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, 2008
8. Ligji për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë, 2010
9. Ligji për Këshillin e Sigurisë së Kosovës, 2008

### BURIMET SEKONDARE

10. Departamenti Amerikan i Shtetit, *Raportet e Shteteve për Terrorizmin 2009* (Gusht 2010)
11. Instituti GAP, *Rregulla 61: Ligjet e Ahtisaarit – konsequencat dhe mësimet e nxjerra nga aprovimi i ligjeve në procedurë të përshpejtuar* (Dhjetor 2010)
12. Instituti Kosovar për Zhvillim të Politikave dhe Huluntim (KIPRED), *Shërbimet në hije të inteligjencës në Kosovë: Shpërbërje, Shkrirje apo Integrim?* (Prishtinë: KIPRED, 2006)
13. KLAN Kosova, *Intervistë me Drejtorin e SHIK, Kadri Veseli*, 28 Dhjetor 2009
14. Lajme Dervina ([www.lajme.dervina/archive/arkivi.php](http://www.lajme.dervina/archive/arkivi.php))
15. OJQ e Kosovës, *Raporti i Progresit – Made in Kosova*, Shtator 2011
16. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) , *Analiza e Kontekstit për Reformën e Sektorit të Sigurisë në Kosovë, 1999-2009* (Prishtinë: QKSS, 2011)
17. QKSS, *Funksionet e kontrollit të institucioneve të pavarura të shtetit në sektorin e sigurisë në Kosovë*, (Prishtinë: QKSS, 2010)
18. RBSS, *Rishikimi i Brendshëm i Sektorit të Sigurisë në Kosovë* (Prishtinë: RBSS, 2006)

19. RTK, *Deklaratë publike e drejtorit të SHIK*, Kadri Veseli, 15 Qershor 2008
20. RTK, *Intervisë me Drejtorin e AKI*, Bashkim Smakaj, Janar 2011
21. Veseli, Kadri. SHIK-u 1999-2008, *Rrethanat e veprimit dhe përfundimi i misionit, "Zëri"*, 17 Marrs 2011
22. Zyra e Përfaqësuesit Special të Kombeve të Bashkuara, *Propozimi final gjithpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës* (Mars 2007)